

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА  
БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



## Наставна програма

**АЛБАНСКИ ЈАЗИК (ЈАЗИК НА ЗАЕДНИЦАТА)**

за V одделение

## Programi mësimor

**GJUHË SHQIPE (GJUHË E BASHKËSIVE)**

për klasën V

Скопје, Shkup, 2023

## TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

<b>Lënda mësimore</b>	Gjuhë shqipe (Gjuhë e bashkësive)
<b>Lloji/kategoria e lëndës mësimore</b>	Lëndë zgjedhore
<b>Klasa</b>	V (e pestë)
<b>Tema/fusha programore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Unë, familja ime, shtëpia dhe miqtë e mi</li> <li>• Shkolla, vendbanimi, interesat dhe koha e lirë</li> <li>• Trupi ynë, shëndeti dhe të ushqyerit</li> </ul>
<b>Numri i orëve</b>	2 orë në javë / 72 orë në vit
<b>Pajisjet dhe mjetet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kompjuter, printer, projektor, tabelë, afishe (postera);</li> <li>• fotografi, ilustrime me figura, sende të nevojshme, letra ngjitëse;</li> <li>• material për të bërë kartolina për ditëlindje: letër, gërshtë, letër me ngjyra, ngjitës, blloqe, plastelinë, ngjyra druri, markerë.</li> </ul>
<b>Normativi për kuadrin mësimor</b>	<p>Mësimdhënjen e lëndës së gjuhës shqipe si lëndë zgjedhore në klasën e V të arsimit fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi i cili ka kryer drejtimin arsimor të programeve studimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi*</li> </ul> <p><i>* Sipas Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Neni 10, paragrafi (3): “Kur në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni, do të paraqiten më shumë kandidatë, përparësi u jepet mësimdhënësve që kanë shkallë më të lartë të arsimit të lartë përkatës dhe sukses më të lartë gjatë studimeve deridiplomike”.</i></p>

## NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit që përmenden në Programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Përdorimi i gjuhëve të tjera.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
II-A.1	të kuptojë fjalitë dhe frazat që përdoren shpesh dhe që kanë të bëjnë me fusha të afërta me rëndësi personale (të tilla, si informacione personale dhe familjare, nevoja dhe interesa të ndryshme);
II-A.2	të nxjerrë porosinë kryesore nga mesazhet e thjeshta e të qarta, nga njoftimet, nga udhëzimet nga lutjet etj.;
II-A.4	të gjejë informacione konkrete në tekste reale të ndryshme (p.sh. në reklama, në plane, në udhëzime, në broshura, në lista ushqimesh, në orare udhëtimesh etj.) dhe të kuptojë mesazhe të shkurtra të thjeshta, për të menaxhuar situatat e përditshme;
II-A.6	të shqiptojë qartë dhe saktë të gjithë tingujt dhe grupet e tingujve, duke respektuar rregullat e theksit dhe intonacionit, ndërkohë që parregullsitë e mundshme të mos e pengojnë komunikimin;
II-A.7	të përdorë shprehje të zakonshme dhe fjali që përdoren gjatë përvojës së drejtpërdrejtë dhe/ose u referohen temave dhe situatave me interes të drejtpërdrejtë;
II-A.8	të shkruajë fjalë dhe shprehje me saktësi relative, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	të mësuarit e një gjuhe tjetër lehtëson mësimin e shumë gjuhëve dhe mundësinë e komunikimit me anëtarë të grupeve të ndryshme kulturore/gjuhësore;
I-B.3	përmes të mësuarit të gjuhëve të tjera zhvillohet interesi dhe respekti për gjuhët dhe kulturat e ndryshme.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimin e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;

V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të sillet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet mes njerëzve në bazë të cilësdo përkatësie (gjinore, etnike, të moshës, të aftësive, të statusit social etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjytimeve të vetja e të të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore.
<i>Nxënësi /nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerr është me pasojat për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;

V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.
-------	--

## REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: **UNË, FAMILJA IME, SHTËPIA DHE MIQTË E MI**

Gjithsej: 22 orë

### Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

- të zhvillojë bisedë të shkurtër formale dhe joformale duke përdorur modele adekuate të mirësjelljes.
- të prezantojë veten dhe anëtarët e familjes më të gjerë, shtëpinë dhe shokët duke përdorur emra, mbiemra, forma adekuate të përemrave dhe të foljes *jam* dhe *kam*.
- të dallojë, të lexojë dhe të shkruajë shkronjat e dorës të alfabetit (latin) të gjuhës shqipe në fjalë dhe fjali të shkurtra.
- të kuptojë domethënien e një numri të caktuar fjalësh dhe t'i përdorë ato në kontekst përkatës në bisedë joformale (miq, anëtarë të familjes, ambiente të shtëpisë).

### Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

a) funksionet gjuhësore:

- Përshëndetje, biseda formale dhe joformale (modele të mirësjelljes)  
(*Ju në vetën e dytë shumës në bisedë formale*)  
Përshëndetje / Mirëdita, Mirëmëngjesi / Mirëmbrëma  
Unë jam/Ai është/ Ju jeni  
Si je/Si jeni?  
Mirë, faleminderit

### Standardet për vlerësim:

- Dallon dhe përdor shprehje përshëndetëse dhe lamtumirëse varësisht nga bashkëbiseduesit dhe situatat.
- Dallon dhe përdor shprehje përshëndetëse duke e përdorur vetën e dytë shumës kur u drejtohet njerëzve më të rritur në shkollë në biseda formale.
- Merr pjesë në dialog të shkurtër ku bën prezantimin e miqve / shokëve, fqinjëve, anëtarëve të familjes duke përdorur forma të foljes *jam* në kohën e tashme, përemra dëftorë, përemra pronorë, emra dhe mbiemra cilësorë.
- Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve duke ndërtuar fjali të shkurtra në lidhje me miqtë / shokët dhe familjen.
- Bën prezantimin e shtëpisë dhe i emërton ambientet e shtëpisë.

<p>Urdhëro/Urdhëroni Të lutem/Ju lutem</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prezantimi i shokëve Përshëndetje, unë jam Adrijani. Kjo është shoqja ime Ajla. Ajo ka 10 vjet (Ajo është 10 vjeçe) Kush është kjo? Kjo është/Ajo është <i>Kjo është Ema, ajo është nxënëse, ajo është shumë e sjellshme. Ky është Arifi, ai është nxënës, ai është në klasën e pestë.</i></li> <li>• Prezantimi dhe përshkrimi i anëtarëve të familjes më të gjerë: <i>Kush është kjo (ky) /Kjo (Ky) është....(gjyshja, gjyshi, kushëriri, kushërira, halla, tezja, xhaxhai, daja)</i>  <i>Kjo grua është gjyshja ime, ajo është shumë e dashur. Ky fëmijë është kushëriri im Zorani, ai është i vogël.</i></li> <li>• Prezantimi i shtëpisë <i>Kjo është shtëpia ime, dhoma ime. Kjo është kuzhina dhe dhoma e ditës, këto janë dhomat e fjetjes dhe banja.</i></li> </ul>	
<p>b) Njësitë leksikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Familja, miqtë, shtëpia – emrat: shok/shoku; mik/miku; farefis/farefisi;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton dhe numëron anëtarë të familjes së afërt dhe të gjerë duke përdorur trajtën e shqar dhe të pashqar të emrit.</li> <li>• Bën përshkrimin e anëtarëve të familjes së gjerë dhe të shokëve duke përdorur emra dhe mbiemra cilësorë (për pamjen fizike apo ndonjë tipar).</li> </ul>

<p>prindër/prindërit; kushëri/kushëri; nip/nipi;  xhaxha/xhaxhai; hallë/halla; dajë/daja; teze/tezja;  fqinj/fqinji; burrë/burri; grua/gruaja,  fëmijë/fëmijët; vajzë/vajza; djalë/djali;  motër/motra; vëlla/vëllai; shtëpi/shtëpia;  banesë/banesa; dhomë/dhoma; banjë/banja;  kuzhinë/kuzhina</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbiemrat: i/e gjatë, i/e shkurtër, i/e moshuar, i ri/e re, i sjellshëm/e sjellshme, i/e dashur, i/e mirë, i madh/e madhe, i/e vogël, i/e gjerë, i/e ngushtë; trim/trimëreshë, simpatik/e, shembullor/e, kryelartë, zemërmirë</li> <li>• Ndajfoljet: shumë, pak</li> <li>• Numrat deri në 20 dhe dhjetëshet deri në 100</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor leksik të duhur për të bërë prezantimin e ambienteve të shtëpisë.</li> <li>• Përdor ndajfoljet <i>shumë, pak</i> për të treguar sasi.</li> <li>• I thotë numrat deri në 20 dhe dhjetëshet deri në 100.</li> </ul>
<p>c) Strukturat gramatikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përemrat vetorë: <i>unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato</i></li> <li>• Përemrat pronorë: <i>nëna ime/ gjyshi im / motra e tij, vëllai i saj</i></li> <li>• Përemrat dëftorë: <i>ky, kjo, ai, ajo, këta, këto, ata, ato</i></li> <li>• Përemrat pyetës: <i>ç' / çfarë /çka; kush; cili / cila / cilët/cilat</i></li> <li>• Përemrat pronorë: <i>im, yt, ynë, juaj, i/e tij, i/e saj</i></li> <li>• Format e foljes <i>jam</i> dhe <i>kam</i> në kohën e tashme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor përemrat vetorë në bisedë dhe komunikim të ndërsjellë.</li> <li>• Përdor përemra dëftorë për të treguar persona dhe sende të cilët janë në distancë të ndryshme hapësinore.</li> <li>• Përdor fraza duke përdorur emra dhe përemra pronorë kur shpjegon marrëdhëniet në familje.</li> <li>• Bën pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve duke përdorur përemra pyetës.</li> <li>• Përdor përemra dëftorë dhe përemra pronorë gjatë prezantimit dhe përshkrimit.</li> <li>• Përdor forma të foljes <i>jam</i> dhe <i>kam</i> në kohën e tashme në vetë dhe numër të duhur në fjali dëftore dhe pyetëse.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>Fjalitë dëftore dhe pyetëse</li> </ul>	
<p>ç) Të shkruarit me shkronja të dorës të alfabetit (latin) të gjuhës shqipe.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon dhe shkruan shkronja të dorës të alfabetit (latin) të gjuhës shqipe.</li> <li>Përdor shkronja të dorës të alfabetit (latin) të gjuhës shqipe për të shkruar emrin dhe mbiemrin e vet, shkollën dhe të kopjojë dialogë të shkurtra.</li> <li>Shkruan fjali të thjeshta.</li> </ul>
<p>d) Të lexuarit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lexon fjalë, fjali, dialogë dhe tekste të shkurtra duke i respektuar shenjat e pikësimit.</li> </ul>
<p>e) Përmbajtjet ndërkulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Dasma, martesë, nusja, dhëndri, krushqit/dasmorët, ftesa, urimet, dhuratat, torta)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përshkruan dasmën dhe tregon pjesëmarrësit (nusja, dhëndëri, krushqit/dasmorët).</li> <li>Përdor shprehje/fraza përshëndetëse të reja që sapo i ka përvetësuar.</li> </ul>
<p><b>Shembuj të aktiviteteve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit përshëndeten në çifte duke marrë role të ndryshme dhe duke i ndryshuar situatat e bisedave: në dyqan, gjatë takimeve me më të rritur dhe me fëmijë në fqinjësi etj.</li> <li>Nxënësit simulojnë situata reale nga jeta e shkollës, për shembull shkruarja në bibliotekë për të huazuar libër: <i>Mirëdita, a e keni librin...nga...Po, faleminderit, ju lutem ma jepni.</i></li> <li>Nxënësit sjellin fotografi të familjes dhe i prezantojnë sipas modeleve të dhëna: <i>Kjo është kushërira ime Sanja, ajo ka 15 vjet.</i></li> <li>Nxënësit luajnë role sipas një modeli të dëgjuar dhe prezantojnë veten dhe shokët e tyre duke përdorur përemra vectorë me foljen <i>jam</i> dhe <i>kam</i>, p.sh. <i>Unë jam Ado Iljas, kam 10 vjet, ai është shoku im Martini. Ajo është fqinja Sefa dhe bashkëshorti i saj Qemali.</i></li> <li>Nxënësit në çifte bëjnë përshkrimin e shokëve, pastaj i paraqesin në vizatim.</li> <li>Nxënësit krijojnë strip me dy tri vizatime të vogla duke ilustruar ambientet e shtëpisë së tyre apo ndonjë person të cilin e përfytyrojnë.</li> <li>Nxënësit sjellin fotografi me anëtarët e familjes dhe i tregojnë marrdhëniet me to duke i përdorur shembujt e mësuar më parë.</li> <li>Nxënësit nëpërmjet fotografisë apo vizatimit prezantojnë ndonjë të afërm të tyre për të cilin tregojnë disa mbiemra që kanë të bëjnë me ndonjë karakteristikë fizike apo theksojnë ndonjë veti.</li> <li>Nxënësve u jepen karta me emërtime të ambienteve të shtëpisë të cilat i vendosin pranë ilustrimeve përkatëse.</li> </ul>	



- Nxënësit punojnë në fletë pune me vizatime në të cilat do të shënojnë replika të shkurtra me përemra vetorë dhe përemra dëftorë. *P.sh. Përshëndetje, unë jam Ana, ky është Tomi. Kush janë ata fëmijë? Ata janë Nora dhe Blerimi.*
- Nxënësit në bazë të vizatimeve lexojnë dhe plotësojnë fjali me emra dhe përemra pronorë: *Nëna ime është në shtëpi.*
- Nxënësit krijojnë një dialog të shkurtër autentik bazuar në një model të dhënë dhe e prezantojnë përpara gjithë klasës.
- Nxënësit janë të ndarë në grupe të vogla dhe luajnë lojën “Pyetje dhe përgjigje” – *Kush lexon? Maja lexon. Kush shkruan? Sara shkruan. Çfarë lexoni? Ne lexojmë libër.*
- Nxënësve u jepen karta me disa fotografi, ilustrime të familjes ose të shokëve. Nxënësit i emërtojnë dhe i përshkruajnë: *Kjo grua është nëna ime. Nëna ime është shumë e mirë. Ky është Onuri, ai është shumë i gjatë.*
- Nxënësit lexojnë fjali dhe shënojnë e saktë / e pasaktë për thënie ku folja *jam* është përdorur në vetën dhe numrin e duhur. *Ajo është klasa e pestë. Ai është i madh. Unë jam nxënës.*
- Nxënësit lexojnë fjali dhe shënojnë e saktë / e pasaktë për thënie ku folja *kam* është përdorur në vetën dhe numrin e duhur. *Unë kam një motër, Igori ka lodra, Ata kanë shumë shokë.*
- Nxënësit në grupe luajnë lojën “shëno fjalën e duhur”. U jepen në fletë pune shkronja me rend të përzier, ndërsa shkronja që duhet të jetë e para është më e errësuar. *P.sh. s a l p – laps.*
- Nxënësit kopjojnë një dialog, e nënshkruajnë (emrin dhe mbiemrin) dhe pastaj e ndërrojnë me shokun me qëllim që të kontrollojnë sa të suksesshëm kanë qenë.
- Nxënësit në çifte shkruajnë fjali të thjeshta (dëftore) të cilat u janë dhënë me rend të përzier. Pasi t'i formojnë i lexojnë në mënyrën e duhur.
- Nxënësve u jepen fotografi nga një dasmë (nuse dhe dhëndër, vallëzime, prerja e tortës, pranimi i dhuratave) të cilat i shfrytëzojnë për t'i emërtuar pjesëmarrësit dhe me fjali të shkurtra përshkruajnë ngjarjen dhe më pas shkruajnë një urim.

Tema: **SHKOLLA, VENDBANIMI, INTERESAT DHE KOHA E LIRË**

Gjithsej: 30 orë

#### **Rezultatet e të nxënit:**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të kuptojë domethënien e njesive mësimore të dëgjura që kanë të bëjnë me shkollën, vendbanimin, aktivitetet e lira dhe të reagojë në mënyrën e duhur ndaj tyre (verbalisht dhe joverbalisht).
2. të zhvillojë bisedë dhe dialogë të shkurtër në lidhje me vendbanimin, aktivitetet e lira duke shfrytëzuar njësitë e duhura leksikore në modelet e përcaktuar.

3. të numërojë ditët e javës dhe të tregojë sa është ora.
4. të përgjigjet në pyetje *ku* dhe *kur*.
5. të formojë fjali të shkurtra me përdorimin e duhur të përemrave (vetorë, dëftorë, pronorë dhe pyetës), mbiemrave dhe emrave në gjininë, numrin dhe trajtën e duhur dhe formave foljore për kohën e tashme.
6. të lexojë dhe të kuptojë tregime ose/dhe dijalogë të shkurtër që kanë të bëjnë me shkollën, vendbanimin dhe shtëpinë.
7. të përdorë shkronjat e dorës (latine) të gjuhës shqipe dhe të përdorë saktë shkronjën e madhe gjatë të shkruarit.
8. të numërojë deri në 20 dhe dhjetëshet deri në 100.

<b>Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):</b>	<b>Standardet për vlerësim:</b>
<p>a) funksionet gjuhësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prezantimi dhe përshkrimi i shkollës, ambientet e shkollës, e klasave, e mjeteve shkollore. <i>Kjo është biblioteka, kjo është salla e sportit</i></li> <li>• Pyetje dhe përgjigje: sa është ora, orari ditore i aktiviteteve, ditët e javës: <i>Ngrihem në ... shkoj në shkollë në ...</i></li> <li>• Prezantimi i vendbanimit (<i>ku jeton, unë jetoj në rrugën..., ai jeton në...</i>)</li> <li>• Interesat dhe aktivitetet që i bën (<i>ku, kur, në sa ora...</i>)</li> <li>• Numërimi deri në 20 dhe dhjetëshet deri në 100.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njih dhe riprodhon informata nga një tekst / dialog / bisedë të dëgjuar në lidhje me shkollën dhe vendbanimin.</li> <li>• Numëron hapësira në shkollë dhe përshkruan mjetet e klasës, mjetet shkollore, vendbanimin.</li> <li>• Tregon sa është ora dhe orarin ditore të aktiviteteve sipas orëve.</li> <li>• Numëron interesat dhe aktivitetet që i bën.</li> <li>• Numëron në kontekste të ndryshme.</li> <li>• Merr pjesë në dialog të shkurtër duke formuluar pyetje dhe përgjigje që përmbajnë njësi leksikore që sapo ka mësuar.</li> <li>• Krijon tregime për shkollën, për vendbanimin dhe për aktivitetet që i bën.</li> </ul>
<p>b) Njësitë leksikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ambiente e shkollës: salla, korridori, zyra, biblioteka; mjetet shkollore, sende nga klasa</li> <li>• Vendbanimi, qyteti, fshati, rruga dhe numri, ndërtesa, shtëpi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëron ambientet dhe përshkruan sendet e mjedisit të tij/saj shkollore dhe mjetet shkollore.</li> <li>• Dallon kuptimin e fjalëve që përshkruajnë mjedisin jetësor dhe i përdor drejt ato.</li> <li>• Pyet dhe përgjigjet në lidhje me adresën dhe vendbanimin.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ditët e javës, ora</li> <li>• Interesat dhe aktivitetet: kori, sporti, futbollu, klubi i dramës</li> <li>• Numrat deri në 20 dhe dhjetëshet deri në 100</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton dhe numëron ditët e javës.</li> <li>• Krijon tregime të shkurtra me informata për orën dhe për ditën.</li> <li>• Riprodhon numrat deri në 20 dhe dhjetëshet deri në 100 në kontekste të ndyshme.</li> </ul>
<p>c) Strukturat gramatikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përemra vetorë: unë,ti,ai/ajo, ne, ju, ata/ato</li> <li>• Përemra dëftorë: ky/kjo/ai/ajo/ata/ato Përemra pyetës: ç' / çka /çfarë/ kush / cili/cila/cilët/cilat, - <i>E kujt është kjo? Çfarë është kjo?</i></li> <li>• Përemrat pronorë (im, ime, yt, jote, i/e tij, i/e saj, ynë, jonë, i tyre, e tyre) - <i>I kujt është lapsi? Lapsi është i Igorit.</i></li> <li>• Emrat – emrat e përgjithshëm, kategoria gramatikore gjinia, numri dhe trajta (shkolla, inventari shkollor dhe mjetet shkollore, vendbanimi, rruga, numri, adresa)</li> <li>• Mbiemrat cilësorë – mbiemrat e njëjshëm (i/e madh, i/e vogël, i/e urtë, i/e mirë, të bukur/a,; mbiemrat që tregojnë ngjyra)</li> <li>• Mbiemrat marrëdhëniorë – mbiemrat e panyjshëm (karrige druri, derë hekuri, filxhan qelqi, vajzë bukuroshe, djalë trim)</li> <li>• Foljet (lexoj, shkruaj, mësoj, dua, jetoj, luaj, vizitoj; përdorimi i foljes <i>jam</i> dhe <i>kam</i>)</li> <li>• Parafjalët: <i>afër, mbi, në, me;</i></li> <li>• Ndajfoljet: <i>tani, sot, në mëngjes, pasdite, në</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor përemrat (vetorë, dëftorë dhe pyetës) gjatë të shprehurit dhe prezantimit.</li> <li>• Përdor përemrat pyetës dhe përemrat pronorë (në formë pyetjeje dhe përgjigjeje).</li> <li>• Pyet dhe përgjigjet duke shprehur pronësinë me njëjën e/i/të.</li> <li>• Përdor emra nga temat që sapo ka mësuar në kategoritë e duhura gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të trajtës.</li> <li>• Përshkruan duke përdorur mbiemrat përkatës cilësorë dhe mbiemrat e njëjshëm në gjini dhe në numër.</li> <li>• Përshkruan duke përdorur mbiemrat përkatës marrëdhëniorë dhe mbiemrat e panyjshëm.</li> <li>• Krijon shprehje të shkurtra duke i përdorur përemrat pronorë.</li> <li>• Përdor foljet në vetën dhe numrin e duhur në kohën e tashme.</li> <li>• Përdor parafjalët në fjali të shkurtra.</li> <li>• Përdor ndajfoljet e kohës dhe të vendit në fjali të shkurtra.</li> <li>• U përgjigjet pyetjeve të thjeshta që kanë të bëjnë me ambientin jetësor duke zbatuar drejt strukturat gramatikore dhe modelet themelore të fjalisë.</li> <li>• Riprodhon dhe prodhon fjali të thjeshta dhe deklaratata.</li> </ul>

<p><i>mbrëmje; lart, poshtë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Fjalìa, fjalìa e thjeshtë</li> </ul>	
<p>ç) Të lexuarit dhe të shkruarit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lexon fjali dhe dialogë me intonacionin e duhur varësisht nga lloji i fjalisë.</li> <li>Shkruan fjali dhe dialogë të shkurtër, duke përdorur shkronjën e madhe gjatë shënimit të emrit, vendbanimeve dhe emërtimeve gjeografike.</li> </ul>
<p>d) Përmbajtjet ndërkulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Monumentet në vendin ku jetojmë</li> <li>Gëzuar Vitin e Ri</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numëron monumentet e vendit ku jeton.</li> <li>Përdor shprehje për urimin e Vitit të Ri dhe krijon tekst urimi.</li> </ul>
<p><b>Shembuj të aktiviteteve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit degjojnë material për pajisjet shkollore, inventarin shkollor, emrat e lëndëve mësimore dhe më pas riprodhojnë njësi leksikore. Pastaj mësimdhënësi/ja u shpërndan ilustrime në të cilat duhet t'i shkruajnë fjalët që i kanë dëgjuar.</li> <li>Nxënësit të ndarë në grupe bëjnë përshkrimin e pajisjeve të tyre shkollore, tregojnë dhe përshkruajnë me mbiemra: <i>Ngjyra druri, mprehëse rozë prej plastike...</i></li> <li>Nxënësit në çift bëjnë numërimin e mjeteve në klasë duke pasur kujdes për gjininë numrin dhe trajtën e emrave dhe mbiemrave: <i>ka tabelë të bardhë, karrige druri, dritare të mëdha, derë ngjyrë kafe, dërrasa e zezë, dritarja e hapur.</i></li> <li>Nxënësit bisedojnë për orarin e tyre ditor: <i>zgjohem në ... shkoj në shkollë në ... bëj detyrat në...</i></li> <li>Nxënësit janë të ndarë në grupe dhe bisedojnë për interesat e tyre: <i>unë dua ...</i></li> <li>Nxënësit simulojnë dialogë të ndryshëm: <i>-Ku jeton ti? -Unë jetoj në rrugën ... -Ku jeton Sara? -Ajo jeton ...</i></li> <li>Nxënësit bisedojnë për aktivitetet që i bëjnë: <i>- A shkon ti në kor? - Jo, unë nuk shkoj në kor. - A shkon ti në futboll? - Po, unë shkoj në futboll - Kur shkon në futboll? - Në futboll shkoj ditën e premte në orën 8.</i></li> <li>Nxënësit në fletë mësimore bëjnë lidhjen e fjalëve me objektet e shënuara në ilustrime, pastaj shqiptojnë/ thonë fjali të shkurtër për atë (<i>Dërrasa është e zezë. Lapsi është i gjelbër. Shkolla është e madhe. Klasa është e vogël</i>).</li> <li>Nxënësit shënojnë fjalë nga ambienti jetësor që i kanë të njohura (rruga, shtëpia, adresa...), pastaj i ndërrojnë me shokun dhe thonë fjali të shkurtra. <i>P.sh. Shtëpia jote është e verdhë. Rruga është e madhe.</i></li> <li>Nxënësit në çift i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe përgjigjen: <i>A jetoni në banesë (apartament),? Jo, jetoj në shtëpi. Blerimi jeton në këtë shtëpi? Po, Blerimi jeton në këtë shtëpi.</i></li> <li>Nxënësit marrin karta me emrat e ditëve të javës dhe i radhisin ato nga e hëna deri të dielën.</li> </ul>	

- Nxënësit i bëjnë pyetje njëri-tjetrit në çift: *Çfarë dite është sot? Sot është e premte. Sa është ora? Tani është ora 10.*
- Nxënësit në grupe bëjnë një orë letre me akrepa lëvizës. Njëri nga grupi e thotë orën, tjetri i rregullon akrepat e orës. Rolet në grup ndërrohen.
- Nxënësit në një grup rendisin letra me numra pranë njëri-tjetrit dhe poshtë tyre i vënë kartat me numrat përkatës të shkruar me fjalë.
- Nxënësit shikojnë një strip me personazhe të famshme të filmave vizatimorë, parashtrojnë pyetje duke përdorur trajta të ndryshme të përemrave pyetës dhe dëftorë: *Cili/cila është ky/kjo? Ky/kjo është ...*
- Nxënësit simulojnë dialogë me përemra pyetës dhe përemra pronorë si pyetje dhe përgjigje: *E kujt është kjo? Është imja.*
- Nxënësit ndahen në grupe, në secilin grup nxënësit lënë një nga mjetet e tyre shkollorë në bankë. Pyesin dhe përgjigjen duke shprehur pronësinë: *I kujt është stilolapsi? Stilolapsi është i Anës.*
- Nxënësit emërtojnë atë që dinë nga një ilustrim që paraqet një rrugë, një shkollë dhe ndërtesa banimi, duke i kushtuar vëmendje përdorimit të saktë të fjalëve emërtuese.
- Nxënësit në çift marrin disa figura me objekte të ndryshme dhe shkruajnë mbiemrat përkatës për to.
- Nxënësit krijojnë shembuj që shprehin pronësi: *Ky është libri im. Ai është lapsi i tij.*
- Nxënësit marrin ilustrime për të cilat duhet të përgjigjen kush çfarë bën, p.sh. *Merti shkruan. Suati lexon. Melita luan. Kani dhe Izeta mësojnë.*
- Nxënësit shohin një ilustrim të cilin mësimdhënësi/ja e tregon te tabela inteligjente, më pas hartojnë fjali të shkurtra duke përdorur parafjalët përkatëse, p.sh. *Topi është nën tavolinë. Lapsi është në bankë. Macja është mbi çati.*
- Nxënësit ndahen në grupe dhe luajnë një lojë, një nxënës nga një grup numëron deri në njëqind duke përdorur vetëm dhjetëshet dhe një nxënës nga një grup tjetër fsheh një objekt në klasë. Nxënësi që numëroi kërkon objektin dhe shokët e klasës nga grupi i tij i japin udhëzime se ku të kërkojë: *në të djathtë të dritares, në të majtë të derës, lart, poshtë, në, nën, mbi...* Grupet dhe rolet e nxënësve ndërrohen.
- Nxënësit luajnë *Bingo* me numra ku mësimdhënësi/ja u jep karta bingo me numra deri në 20 duke shpjeguar rregullat e lojës. Më pas njëri nxënës thotë numrat deri në 20 dhe të tjerët plotësojnë kartat e bingos. Nxënësi i parë që plotëson një rresht bërtet *Bingo!* dhe lexon numrat nga rreshti.
- Mësimdhënësi/ja jep një tekst të shkurtër me fjalë të hequra (që mungojnë) me temën: veprimtaritë, ditët e javës dhe orën, kurse nxënësit dallojnë fjalët dhe shprehjet e dhëna në kontekst dhe i shkruajnë në vendin e duhur. *p.sh. Unë shkoj në basketboll të shtunën në orën 15:00.*
- Nxënësit dëgjojnë material mbi një temë të caktuar dhe riprodhojnë dhe prodhojnë fjali dhe pohime të thjeshta.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst të shkurtër dhe më pas shkruajnë dy fjali që i mbajnë mend. Pastaj kontrollojnë shoku-shokun a i kanë shkruar

saktë fjalët në fjali.

- Nxënësit shkruajnë emrin dhe mbiemrin e tyre, qytetin/fshatin ku jetojnë, malin më të afërt dhe lumin më të afërt, duke i kushtuar vëmendje përdorimit të shkronjave të mëdha.
- Nxënësit të ndarë në grupe lexojnë një tekst me leksik të pasur nga tema. Në secilin grup, ata shkruajnë nga dy pyetje me *ku* dhe *kur* për tekstin dhe u përgjigjen pyetjeve. Në fund secili grup prezanton.
- Në një bashkëbisedim, nxënësit numërojnë pikat e referimit në qytet (monumentet, ndërtesat fetare, vendet arkeologjike).
- Nxënësit hartojnë një kartolinë të shkurtër të përshtatshme për Vitin e Ri.

Tema: **TRUPI YNË, SHËNDETI DHE TË USHQYERIT**

Gjithsej: 20 orë

**Rezultatet e të nxënit:**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të kuptojë domethënien e njërive leksikore të dëgjua që lidhen me pjesët e trupit dhe të ushqyerit dhe reagon në përputhje me to (verbalisht dhe joverbalisht).
2. të numërojë pjesët e trupit dhe të kokës.
3. të zhvillojë një bisedë dhe dialogë të shkurtër rreth të ushqyerit duke përdorur njësi leksikore, emra dhe mbiemra të përshtatshëm, në kategoritë e duhura / përkatëse të gjinisë të numrit dhe të trajtës.
4. të hartojë fjali të shkurtra duke përdorur saktë përemrat (vetorë, dëftorë, pronorë dhe pyetës), mbiemrat dhe emrat në gjininë, numrin dhe trajtën e duhur dhe trajtat foljore për kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme.
5. të shkruajë, lexojë dhe kuptojë deklarata (pohime) të shkurtra dhe/ose dialogë të shkurtër lidhur me shëndetin dhe të ushqyerit dhe u përgjigjet pyetjeve rreth tyre.

**Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):**

a) Funksionet gjuhësore:

- Paraqitja e pjesëve të trupit dhe pjesëve të kokës  
*Kjo është koka, dorë-duar, këmba-këmbët, shputa ose Ajo ka sy të kaltër dhe flokë të zeza.*

**Standardet për vlerësim:**

- Njih dhe rendit pjesët e trupit (duke përdorur përemrat dëftorë, emrat dhe trajtat përkatëse të kohës së tashme).
- Njih dhe rendit pjesët e kokës.
- Emërton dhe paraqet vaktet (shujtat), prodhimet ushqimore, frutat dhe perimet.
- Merr pjesë në një dialog të shkurtër duke formuluar pyetje dhe përgjigje që

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërtimi dhe prezantimi i vakteve/shujtave dhe prodhimeve ushqimore, frutave dhe perimeve <i>Ushqimi/shujta : mëngjes, drekë, darkë.</i> <i>Unë ha mëngjes.</i> <i>Për mëngjes ha fruta.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• përmbajnë njësi leksikore që ka mësuar.</li> <li>• Harton deklarata (pohime, shprehje) me funksione përkatëse të gjuhës.</li> </ul>
<p>b) Njësitë leksikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesë të trupit, pjesë të kokës (kokë, dorë, krah, këmbë, shputë, sy, hundë, gojë)</li> <li>• Vakte (shujta): mëngjes, drekë, darkë</li> <li>• Fruta dhe perime (fruta: mollë, dardhë, banane, luleshtrydhe / dredhëzë, qershi dhe perime: domate, spec, lakër, misër, patate, oriz); prodhime të tjera (bukë, qumësht, mish, vezë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton domethënien e njësive leksikore që emërtojnë pjesët e trupit dhe të kokës.</li> <li>• Kupton domethënien e njësive leksikore që emërtojnë ushqimet, frutat dhe perimet.</li> <li>• Identifikon dhe dallon njësitë leksikore të parapara që tregojnë prodhime të ndryshme ushqimore, perime dhe fruta.</li> <li>• Tregon prodhime ushqimore të etiketuara si ushqim i shëndetshëm.</li> <li>• Harton fjali të shkurtra me njësi leksikore që ka mësuar.</li> </ul>
<p>e) Strukturat gramatikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përemrat vetorë: <i>unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato;</i></li> <li>• Përemrat dëftorë: <i>ky/ai/ajo; këta/këto, ata/ato;</i></li> <li>• Përemrat pyetës: <i>kush / çfarë</i></li> <li>• Emrat – emrat e përgjithshëm, kategoria e gjinisë e numrit dhe e trajtës: pjesët e trupit, fruta, perime, ushqime)</li> <li>• Mbiemrat cilësorë (<i>i madh, i vogël, i shijshëm, i shëndetshëm</i>); mbiemra që tregojnë ngjyra;</li> <li>• Përemrat pronorë (<i>e imja, imi, e jotja, yti, e tij, e saj, e jona, i yni, i tyre....</i>)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor përemrat në vetën dhe numrin e duhur duke i përshtatur me foljet.</li> <li>• Përdor emrat në gjininë, numrin dhe trajtën e duhur, duke i përshtatur me mbiemrat.</li> <li>• Numëron dhe tregon pjesët e trupit dhe të kokës duke përdorur përemrat vetorë, emrat dhe trajtat e duhura të foljeve (ndihmëse) <i>jam</i> dhe <i>kam</i>.</li> <li>• Përdor mbiemra përshkruar për të paraqitur frutat dhe perimet.</li> <li>• Përdor përemrat dëftorë dhe emrat në gjininë, numrin dhe trajtën e duhur për të paraqitur ushqimin e shëndetshëm.</li> <li>• Harton fjali të shkurtra duke përdorur saktë ndajfoljet.</li> <li>• Harton fjali të shkurtra me njësitë leksikore të dhëna, duke përshtatur me trajtat e foljes (vetën, numrin dhe kohën) për temën e vakteve dhe ushqimit.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>Foljet (<i>në kohë e tashme, e shkuara dhe e ardhme: ha, ndihmoj; hëngra, ndihmova; do të ha, do të ndihmoj; përdorimi i foljeve jam dhe kam</i>);</li> <li>Parafjalët: <i>për, mbi, në, nën...</i>;</li> <li>Ndajfoljet: <i>tani, sot, në mëngjes, pasdite, shumë, pak</i></li> </ul>	
ç) Të lexuarit me të kuptuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lexon drejt, duke theksuar fjalët.</li> <li>U përgjigjet pyetjeve të thjeshta për një tekst të lexuar (<i>kush, ku, kur</i>).</li> </ul>
f) Përmbajtjet ndërkulturore: Ushqim tradicional për mëngjes/drekë/darkë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Emërton gatime tradicionale të të gjitha kulturave nga vendi ynë.</li> <li>Emërton përbërësit për përgatitjen e ushqimeve tradicionale.</li> </ul>
<p><b>Shembuj të aktiviteteve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit në çifte i japin njëri-tjetrit detyra: tregojnë dorën, këmbën, kokën, hundën... Fillimisht tregojnë dhe më pas përsërisin fjalët dhe fjalitë e shkurtra: <i>Kjo është ...</i></li> <li>Nxënësit punojnë në çifte, vizatojnë fytyrat e njëri-tjetrit dhe më pas i tregojnë njëri-tjetrit pjesët e kokës.</li> <li>Nxënësit marrin një fletë pune: vizatojnë një vakt / shujtë mëngjesi të rëndomtë, drekë, darkë dhe përsërisin tri leksemat: <i>mëngjes/i, drekë/a, darkë/a</i>.</li> <li>Nxënësit në çifte marrin karta me fruta dhe perime, i emërtojnë dhe i përshkruajnë me një ose më shumë mbiemra.</li> <li>Nxënësit parashtrojnë pyetje: <i>Çfarë është kjo? Kjo është mollë, dardhë, domate, spec, lakër, bizele...</i></li> <li>Nxënësit në çifte hartojnë deklarata / pohime: <i>Për darkë ha... Në mëngjes ha...</i></li> <li>Nxënësit lidhin dhe emërtojnë fjalët që u referohen objekteve të paraqitura në afishe, i thonë dhe i shkruajnë ato.</li> <li>Nxënësit marrin një fletë mësimore (pune) me emrat e frutave dhe perimeve dhe foto të vogla pranë tyre, të cilat duhet t'i lidhin mes vete.</li> </ul>	



Këto i kontrollojnë në çifte.

- Nxënësit bëjnë fletushka për të promovuar ushqimin e shëndetshëm, vizatojnë ushqim të shëndetshëm dhe shkruajnë një mesazh të shkurtër.
- Disa nxënës bëjnë një kuiz me pyetje në lidhje me temat që i kanë mësuar, kurse të tjerët u përgjigjen pyetjeve me saktë / e pasaktë.
- Nxënësit marrin një fletë mësimore dhe plotësojnë vendet e zbrazëta në fjali me përemrin që mungon ose një folje që duhet të vendoset në vetën dhe numrin e duhur. *Mua më pëlqen shumë molla.*
- Nxënësit lexojnë fjali të shkurtra dhe plotësojnë me mbiemra përkatës që do të përputhet me emrin sipas gjinisë, numrit dhe kuptimit: *Ajo pëlqen mollët e mëdha të kuqe.*
- Nxënësit marrin një fletë mësimore, me vizatim të trupit, ku janë lënë vija në të cilat do të shkruajnë pjesët e trupit të vizatuar.
- Në një vizatim me fruta dhe perime të caktuara, nxënësit shkruajnë disa mbiemra për të përshkruar secilën prej tyre (*i shëndetshëm, i shijshëm, i kuq...*)
- Nxënësit marrin material pamor, të cilin e presin dhe e ngjyrosin (fruta dhe perime) dhe hartojnë fjali të shkurtra për ta paraqitur atë.
- Në një fletë mësimore me ilustrime dhe me fjalë janë paraqitur fruta dhe perime, kurse nxënësit shënojnë atë që ju pëlqen më shumë me shenjën e saktë (V)
- Nxënësit hartojnë fjali të shkurtra duke përdorur drejt ndajfoljet. (*Unë pi lëng në mëngjes*).
- Nxënësit hartojnë fjali të shkurtra me njësitë leksikore të dhëna dhe në trajtat përkatëse të foljeve në kohën e tashme, e shkuar dhe e ardhme (vetën dhe numrin) me temë të vakteve / shujtave dhe të të ushqyerit, *p.sh. Çfarë dëshiron të hash për drekë? Unë dua... Çfarë hëngri Semra për mëngjes? Ajo hëngri...*
- Nxënësit lexojnë një tekst të shkurtër prej 3-4 fjalish dhe u përgjigjen pyetjeve të shkurtra rreth tij – kush dhe çfarë thotë në tekst.

- Nxënësit shikojnë një pjesë të materialit video (emision televiziv, material nga interneti) për përgatitjen e një ushqimi tradicional, p.sh.: Fasule të pjekur në furrë; fli; petë; byrek... Pasi shohin materialin, fjalët përsëriten dhe riprodhohen fjali të shkurtra në të cilat shprehen përbërësit për përgatitjen e ushqimit.

## **GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR**

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen nëpërmjet inkuadrimin të të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave /përmbajtjeve/ koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlidhin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

## **VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE**

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve bëhet në bazë të standardeve të dhëna të vlerësimit, duke vënë në dukje anët pozitive për përparimin e nxënësve në përvetësimin e gjuhës dhe jo anët negative të mangësive. Duke pasur parasysh se në klasën e pestë, në lëndën e gjuhës shqipe për nxënësit e komuniteteve të tjera që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe turke i zotërojnë të katër aftësitë gjuhësore: Të dëgjuarit me të kuptuar të përmbajtjes, të lexuarit fillestar me të kuptuar të përmbajtjes, të folurit (interaksion dhe prodhim në të folur) dhe të shkruarit fillestar (interaksion dhe prodhim në të shkruar), mësimdhënësi/ja ndjek dhe vlerëson:

- përgjigjet e dhëna me gojë pyetjeve të mësimeve të mesimdhënësit/ses ose të nxënësve të tjerë dhe pjesëmarrjen e tyre në dialogë të shkurtër duke përdorur fjalorin e përvetësuar;
- reagimet verbale dhe joverbale pas dëgjimit të një thënieje;
- të lexuarit dhe të kuptuarit e thëniesve të shkurtra, dialogëve të shkurtër dhe vjershave të shkurtra;
- të shkruarit saktë të fjalëve, fjalive të shkurtra dhe dialogëve të shkurtër, si dhe shkrimi sipas modelit tingullor - diktimit;
- punimet e nxënësve (afishet, ilustrimet, ditarët);
- detyrat e shtëpisë.

Pas përfundimit të çdo teme, nxënësit marrin vlerësim sumativ përshkruar sipas standardeve të arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ përdoret në periudha të caktuara të vitit shkollor dhe lidhet me përfundimin e temave të veçanta, me tremujorin, me gjysmëvjetorin dhe përfundon me notë numerike në fund të vitit shkollor.

<b>Fillimi i zbatimit të programit mësimor</b>	Viti shkollor 2023/2024	
<b>Institucioni/bartës i programit</b>	Byroja e Zhvillimit të Arsimit	Биро за развој на образованието
<p>Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i arsimit dhe shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe (Gjuhë e bashkësive) për klasën V.</i></p> <p>Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по <i>Албански јазик (Јазик на заедницата) за V одделение.</i></p>	<p>nr. _____ viti _____</p> <p>бр. 12-10211/2 25.10.2023 година</p>	<p>Министер за образование и наука, Дос. Dr. Jeton Shaqiri, с.р.</p> <p>_____</p>